

në Rahovec/Orahovac më 19.07.1998, vëllezërit Beqiri dhe Hazëri me bashkëshortët, djemtë, vajzat dhe familjarët e tjerë u nisën nga ora 3:00 të mëngjesit me qëllim braktisjen e qytetit. Në afërsi të pikës së karburanteve *Agrofer*, pranë pikës së karburanteve *Jaha Petrol*, në rrugë për në Malishevë/Mališevo, policia serbe e ka ndaluar familjen Rexha. Policët e plaçkiten familjen dhe i urdhëruan që të hynte në depon e pikës së karburanteve [Rahovec/Orahovac]. Por, kur zjarri, i cili i kishte kapluar shtëpitë përreth, u zgjerua edhe mbi kulmin e depos, Hazëri me familjarë dolën dhe nisën të vraponin. Policët shtënë ndaj tyre dhe Hazërin e vranë në vend, ndërsa e plagosën rëndë vajzën e tij Dritën në stomak. U plagosën edhe disa anëtarë të tjerë të familjes. Megjithatë, të gjithë ata u strehuan në kanal in e afërt, përpos Hazërit, trupi i të cilit ka mbetur në rrugë. Nga ora 6:00, Beqiri shkoi dhe bisedoi me policët dhe ata i lejuan familjes që me Dritën e plagosur të tërhiqeshin nga vendi i ngjarjes. Por, Drita ndërroi jetë pas pak dhe atë e varrosën në vreshtat në lagjen *Rimnik*. Dritën e kanë rivarrosur më 29.08.1998 në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac. Familjarët e Hazërit nuk kishin njohuri për tetë vjet rresht për fatin e trupit të Hazërit. Në datën 29.09.2006, nga morgu i Prishtinës/Priština atyre u është bërë të ditur se trupi i tij ishte identifikuar. Atëherë mësuan se trupin e Hazërit e kishin gjetur në gropën e bërllokut [prapa varrezave myslimane] në Rahovec/Orahovac. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Hazërit më 3.10.2006 në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac.

Burimet: dekarata N.N, FDH-849; dekarata A.R, FDH-13971; dekarata H.M, FDH-38182; *Rahovec in Flames and Smoke Amidst Continued Serb Shelling*, pasqyra e lajmeve, KIC, 21.07.1998, FDH-29372.

Ferad (Ismail) Daka

(1.06.1941, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, bujk, gjashtë fëmijë)

Qelebie (Hazer Shala) Alirifini

(9.06.1944, shqiptare nga Rahoveci/Orahovac, amvise, tetë fëmijë)

Fatime (Hysen) Bugari

(29.12.1976, shqiptare nga Rahoveci/Orahovac, amvise, një fëmijë)

Ditën e diel, në datën 19.07.1998, përleshjet e armatosura ndërmjet forcave të UÇK-së dhe atyre serbe u intensifikuan në afërsi të lagjeve të Rahoveci/Orahovac: *Përroi/Potok* dhe *Lashic/Laščica*. Familjet Alirifini, Bugari dhe Daka, që banonin në këto lagje, u nisën me kolonën e civilëve drejt Pataçanit të Poshtëm/Donje Potočane. Në krye të kolonës ka qenë makina në të cilën ishin Hysen Bugari dhe Ali Alirifini. Vajza e Hysenit, Fatimja, e cila ishte në muajin e shtatë të shtatzënisë, dhe bashkëshortja e Aliut, Qelebia, gjendeshin në kamion, në mesin e afro 60 grave dhe fëmijëve. Kamionin e ngjiste djali i Hysenit, Nexmedini, ndërkaq me të në kabinë ishte komshiu i tij, Ferad Daka, bashkëshortja, e reja dhe fëmijët e të cilit, gjithashtu, ishin hipur në kamion duke kërkuar shpëtim. Pas tre kilometrave të kaluara, forcat serbe hapën zjarr në drejtim të kolonës, pikërisht kur ajo arriti te vendi i quajtur *Dublanë/Dubljane*, në afërsi të *Varrezave të Shtavices/Štavičino groblje* [Rahovec/Orahovac]. Të gjithë që ishin në kamion zbritën menjëherë dhe ia dhanë vrapit drejt Pataçanit të Poshtëm/Donje Potočane. Feradin e qëlluan për vdekje derisa po dilte nga kabina e kamionit. Nga zjarri i forcave serbe nuk shpëtuan as ata që zbritën nga kamioni. Plumbat e qëlluan Fatimen në stomak. Nuk i kursyen as Qelebijen dhe bashkëshorten e Hysenit, Hedijen. Gratë e plagosura u bartën nga civilët në ambulancën e UÇK-së në fshatin Gajrak [Malishevë/Mališevo]. Por, Fatimja ndërroi jetë në rrugë e sipër. Në mbrëmje, atë e varrosën në varrezat e Gajrakut/Gajrak. Feradin e kanë varrosur djemtë e Hysenit në varrezat e Pataçanit të Poshtëm/Donje Potočane, më 19.08.1998. Qelebija ka mbetur e palëvizshme nga plagët e rënda. E çuan në spitalin e Prishtinës/Priština, ku ndërroi jetë më 5.10.1998. Po atë ditë, e varrosën në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata N.N, FDH-850; deklarata N.N, FDH-879; deklarata A.A, FDH-33488;